



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
AGJENCIA PËR ADMINISTRIMIN E TREGJEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____, _____, 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

1. OBJEKTI I PROCEDURËS: “Eja n’bahçe”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
22114311-5**

VLERA E FONDIT LIMIT TË PËRGJITHSHËM:

1. Fondi limit: **2,900,000 (dy milion e nëntëqind mijë) lekë** pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar autoriteti/enti kontraktor ”Agjencia për Administrimin e Tregjeve” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 përkatësisht është (.....) lekë si dhe në monedhën euro sipas kursit të këmbimit datë është(.....) euro.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.1 Kapaciteti ekonomik –financiar

2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% fondit limit të kesaj procedure prokurimi.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kesaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohej, perkatesisht; Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar. Duke qenë se kjo procedure prokurimi është nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë, rëndësisë së objektit të prokurimit, rëndësisë së Autoritetit Kontraktor, seriozitetit të marrëdhënieve kontraktuale me operatorë ekonomikë me aktivitet të vazhdueshëm në treg gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme është bazuar në vlerën e fondit limit të kesaj procedure, si dhe mbështetet në nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43,b

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008, Për Procedurat Tatimore, neni 64 Deklarata Tatimore.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Shërben për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, me qellim për të parë aftësitë financiare të operatorëve ekonomin

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kriteri quhet i përmbushur nëse në bilancet e 2 viteve të njëpasnjëshme nuk kanë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesitë e veteqeverisjes vendore)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshillave Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.4 Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave

Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore sipas prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.5 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ose
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 41, pika 3*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 41, pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.6 Stafi që kërkohet për realizimin e projektit:

- | | |
|---------------------------------|---------|
| 1. Ekspert i zhvillimit rural | 1 (një) |
| 2. Ekspert Designer | 1 (një) |
| 3. Ekspert PR | 1 (një) |
| 4. Ekspert i sigurisë ushqimore | 1 (një) |

Për ekspertët operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Diplomat përkatëse ose certifikata ose Licenca Profesionale
- CV

Ky kusht do të plotësohet nga operatorit Ekonomik tek formulari i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 në DST.

Ekspert i zhvillimit rural - do të bëjë listën e produkteve dominante, do shikoj se si ndikon ky aktivitet në zhvillimin ekonomik të territorit, analizën e fermerëve me produktet përkatëse, do të hartojë temat e 3 workshope-ve dhe do të lidhë të gjithë elementët e zinxhirit të vlerës. Ky ekspert duhet të ketë në kualifikimet e tij një Certifikatë, (Metodologji e Trajnimit për Zhvillimin e Aftësive Sipërmarrëse dhe Menaxheriale”. Ky kualifikim përdoret gjerësisht në vende të ndryshme për të ndihmuar individë dhe grupet në përmirësimin e aftësive të tyre sipërmarrëse dhe për të nxitur krijimin e bizneseve të reja dhe zhvillimin ekonomik. Duke patur parasysh organizimin e 3 workshop-eve, dhe qëllimin e aktivitetit, eksperti me këtë lloj kualifikimi do të jetë trajneri i fermerëve, i cili do t’u mësojë të kenë aftësi në krijimin e bizneseve të reja.

Ekspert Designer - do të meret me krijimin e konceptit vizual, prodhimin e materialeve vizuale, montimin dhe dekorimin si dhe koordinimin.

Ekspert PR - do të meret me planifikimin dhe strategjinë, krijimin e materialeve të komunikimit, median dhe marrëdhëniet publike si dhe koordinimin e të gjithë eventit.

Ekspert i sigurisë ushqimore - do mentorojë një nga ëorkshope-t në lidhje me sigurinë ushqimore me konceptin nga toka në tavolinë.

***Argumentimi:** Në bazë të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, pika 4, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 41, pika 4), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:*

Nevoja për ekspertët është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për kontratën e shërbimit. Mungesa e këtij staf pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Operatorët ekonomikë, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt kontrate duhet të disponojë staf ose personel të përshtatshëm. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe neni 41, pika 4/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa për staf është e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen.

2.8 Disponimi i mjeteve te meposhtme:

| Nr. | Mjetet | Sasia | Gjendja |
|-----|------------------------|-------|---------------------|
| 1 | Kamioncin deri 3.5 ton | 1 | Pronësi ose me qira |

Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituar të disponojë: Dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentat si: Leja e qarkullimit, Çertifikata e Kontrollit Teknik, Çertifikata e transportit të mallrave/Liçencë, Foto e mjetit (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të disponojë dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/te dhena teknike, ose ekuivalenti i tij/saj)

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 9 ne DST

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Gjithashtu duke patur parasysh kërkesën e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Politikave të Zhvillimit të Tregjeve, lidhur me “transportin”, kërkohet pajisja me një automjet (tip kamionçinë 3.5 ton), në mënyrë që të kryhet transporti i mallrave të fermerëve nga pikat e tyre të grumbullimit drejt destinacionit ku do të zhvillohen aktivitetet.

2.9 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, si dhe të gjitha shpenzimet e parashikuara në shtojcën 5 të specifikimeve teknike.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe të nenit 41, pika 4/ç të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar,

dhe që i vlerëson shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet enenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41 pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të këtij shërbimi, janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe O.E të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të materialeve që do të përdoren për realizimin e shërbimit me objekt: “Eja n’bahçe”, janë si më poshtë vijon:

| <i>1</i> | <i>2</i> | <i>3</i> | <i>4</i> |
|--------------|--|---------------|----------------|
| Numri | Përshkrimi | Njësia | sasia |
| 1. | “Stenda” Ekspozimi për fermerët, me konstruktion Metalik, Lartësia 2 m, gjerësia 80 cm. Sipërfaqja e ekspozimit me përmasa jo më të vogël se 110 x 80, | copë | 2 |
| 2. | “Broshurat”, përmasa A 5, | copë | 1000 (njëmijë) |
| 3. | “Fletë Palosje”, përmasa B 5, | copë | 1000 (njëmijë) |
| 4. | “Roll Up” përmasa 1 x 2, | copë | 6 |
| 5. | “Arka” të Loguara nga të 4 anët e saj (faqet), material “Druri” me Ristela, me përmasat 60 x 40 x 15, | copë | 30 |
| 6. | “Tavolina Plastike” së bashku me mbulesat me përmasat 70 x 70 | copë | 32 |
| 7. | “Karrige Plastike”, | copë | 50 |
| 8. | “Shportë” me diametër jo më të vogël se 30 cm, dhe me lartësi jo më të vogël se 10 cm, | copë | 30 |
| 9. | “Foni” për një sipërfaqe rreth 3000 m2, ku të përfshihen: | set | 1 |

| | | | |
|--|---------------------|--|--|
| | - Mikrofon (Stativ) | | |
| | - Mikser | | |

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Autoriteti Kontraktor, Agjencia për Administrimin e Tregjeve, ka parashikuar të zhvillojë aktivitetin promovues “Eja n’bahçe”.

Përshkrimi i projektit

Referuar viteve të kaluara, bujqësia shqiptare dhe zhvillimi rural kanë hasur mungesën e tregjeve për produktet bujqësore vendase. Rritja e konkurrencës nga tregjet e huaja dhe dobësimi i lidhjeve të fshatit shqiptar me industrinë përpunuese në vend, sollën krahas izolimit të disa zonave rurale të vendit, të njohura për kulturën e tyre bujqësore, edhe një nivel të ulët të pakënaqshëm të të ardhurave të realizuara nga fermerët për produktet e tyre.

Për sa më sipër është menduar realizimi i projektit “Eja n’Bahçe” për prezantimin sa më afër konsumatorit të prodhimeve vendase si dhe për ti dhënë mbështetje fermerëve të zonave rurale.

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për qëllim:

- Organizimin e 3 Workshope-ve, me temë:
 - Siguria Ushqimore
 - Promovimi
 - Marketingu
- Mbështetjen e fermerëve në zonat rurale;
- rritjen ekonomike në zonat rurale;
- prezantimin, promovimin si dhe njohjen produkteve të zonave rurale;
- promovimin dhe nxitjen e turizmit në zonat rurale;
- Sjellja e produktit sa më afër qytetarëve;

Përshkrimi i projektit:

Synimi i këtij projekti është rikthimi i vëmendjes drejt zonave rurale. Ky projekt do të realizohet në 3 (tre) ditë të ndryshme. Secila ditë do të përfshijë disa fshatra të cilat në pozicionimin gjeografik, kanë afërsi mes tyre.

➤ Dita I

do të realizohet me fermerët e fshatrave: Ndroq, Vaqarr, Kashar, Pez, dhe Pezë-Helmës, që do të zhvillohet te Pazari i Ri.

➤ Dita II

do të realizohet me fermerët e fshatrave: Shëngjergj, Dajt, Zall-Herr dhe Zall-Bastar, te që do të zhvillohet te Pazari i Ri.

➤ Dita III

do të realizohet me fermerët e fshatrave: Petrel, Fark, Baldushk, Bërzhitë dhe Krrabë, te që do të zhvillohet te Pazari i Ri.

Ky projekt të përfshijë:

Organizimin e 3 Workshop-eve / Panairove në Pazarin e Ri

- Planifikimi:

Ku do të përfshihet sigurimi i pajisjeve dhe materialeve.

- Struktura:

Një prezantim i shkurtër, me seksione edukative dhe diskutime.

Stenda ekspozimi për fermerët.

Këshilla dhe mentorim nga ekspertët.

- Aktivitete Shtesë:

Demonstrime praktike dhe networking.

(Ktu është konceptuar një tip/lloj tryeze mes palëve të interesuara nga njëra anë dhe fermerëve nga ana tjetër, ku do të diskutohen tema të ndryshme).

- Logjistika:

Ekip mbështetës dhe mbledhje feedback-u.

Fushatë Komunikimi e Aktivitetit

Objektivat dhe audienca.

Kanale Komunikimi:

Media sociale, website, e-mail marketing,

Materialet:

Materiale të ndryshme promovimi si: fletëpalosje, roll up, arka të loguara, shporta, transporti, foni, tryezë e rrumbullakët për bashkëbisedim me fermerët, etj

Aktivitete:

Konkurse dhe evente live.

Monitorimi:

Analiza performancës dhe feedback-u.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

NJËSIA E PROKURIMIT